



OJQ RRJETI I LEVIZJES PAQESORE – (RRLP)

NGO NETWORK OF PEACE MOVEMENT –NOPM

RAPORTI GJASHTE-MUJOR MBI TRANSPARENCËN, PJESËMARRJEN E PUBLIKUT DHE QASJEN NE DOKUMENTE ZYRTARE

**Ky raport mbulon fushat e pjesëmarrjes se publikut ne vendim-
marrje, transparencës se autoriteteve komunale dhe qasjes ne
dokumentet zyrtare për Komunën e Kamenicës, Novo Berdes dhe
Ranilugut**

QERSHOR – DHJETOR 2013

Ky projekt është i përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS)



Përpiluar dhe përgatitur nga Konsulenti: Gazmend Mavriqi

Redaktuar nga:

Besime Tusha dhe Sherafedin Vranja

Publikuar nga Rrjeti i Lëvizjes Paqësore /Network of Peace Movement (NOPM)



Skenderbeu Str. 28

62000 Kamenice, Kosovo

Phone: +377 45 291 127

E-mail: ngo.nopm@gmail.com

www.ngo-nopm.org

Janar 2014

TABELA E PERMBAJTJES

FALENDERIME.....	3
RRETH OJQ-se RRJETI I LEVIZJES PAQESORE (NOPM).....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. PARATHËNIE.....	5
2. PJESEMARRJA E PUBLIKUT NE VENDIM-MARRJE	6
3. TRANSPARENCA	8
4. QASJA NE DOKUMENTE ZYRTARE.....	12
5. TE GJETURAT E RAPORTIT DHE REKOMANDIMET.....	14
6. PERFUNDIMET	15

FALËNDERIME

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga **Fondacioni Kosovar për Shoqëri te Hapur (KFOS)** ne kuadër të projektit **“Rritja e transparencës përmes pjesëmarrjes ne qeverisje, buxhet dhe qasje ne informata publike dhe dokumente”**. Ky raport qe mbulon një periudhe gjashte-mujore, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i OJQ-se NOPM, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm si dhe konsulentit te projektit. Në këtë kontekst, OJQ Rrjeti i Lëvizjes Paqësore /Network of Peace Movement (NOPM) falënderon publikisht të gjithë personat qe punuan ne këtë raport në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti, zyrtareve komunal te tri komunave te Kamenicës, Novo Berdes dhe Ranilugut e ne veçanti **Fondacionit Kosovar për Shoqëri te Hapur (KFOS)** .

RRETH OJQ-SE RRJETI I LËVIZJES PAQËSORE /NETWORK OF PEACE MOVEMENT (NOPM)

OJQ-se Rrjeti i Lëvizjes Paqësore /Network of Peace Movement (NOPM) angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. Po ashtu Organizata jone është thellësisht e angazhuar dhe përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike e me theks te veçante te grave dhe te rinjve si grupe te marginalizuara. OJQ NOPM punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje gjithë përfshirëse te publikut. Gjithashtu, organizata mbështet emancipimin e grave në shoqëri demokratike, promovon te drejtat e njeriut dhe te minoriteteve si dhe angazhohet për mundësi në mënyrë të barabartë në punësim. Nxite shoqërinë civile në mesin e qytetareve e sidomos të rinjve, duke krijuar një ambient demokratik për të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësisë etnike, gjuhën, racën ose fenë dhe promovon të drejtat të njeriut, qeverisjes dhe lirive themelore. OJQ NOPM synonte krijoj një model te qytetarit aktiv për promovimin e qeverisjes lokale (transparencë, përgjegjësi, pjesëmarrje te publikut, buxhetim te drejte si dhe qasje ne dokument zyrtare) dhe te drejtave te njeriut (dialog ndëretnik, barazi gjinore, dhe shërbime për te gjithë – te barabarta). Për fund, OJQ NOPM synon të luftoj indiferencën dhe mos-angazhimin qytetare si dhe ta promovoj dhe te bëjë më aktiv dhe më të

dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet padrejtësive dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pjesëmarrja e publikut në vendim-marrje si dhe mbikëqyrja e institucioneve vendore janë parime themelore të qeverisjes së mirë për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien e proceseve demokratike . Kuvendi Komunal (KK) , Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komiteti për Komunitete përfaqësojnë degën legislative në komunë dhe kanë përgjegjësi për të kryer mbikëqyrjen e organeve ekzekutive - kryetarit dhe administratës komunale. Operacioni legjitim dhe efektiv i kuvendit të komunës si një instrument i mbikëqyrjes kërkon përputhjen e saj me kornizën procedurale përkatëse dhe në veçanti siç përcaktohet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Raporti është fokusuar në efektivitetin e performancës së tri komunave në lidhje me fushat e pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje, transparencës së autoriteteve komunale dhe qasjes në dokumentet zyrtare. Në përgjithësi, raporti është fokusuar në tri aspekte. Së pari, në çështjen e pjesëmarrjes së publikut para fillimit të projektit dhe zhvillimeve në këtë drejtim pas fillimit të projektit përkatësisht zbatimit të aktiviteteve si dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje. Aspekti dytë ka qenë transparenca e komunave para dhe fillimi të projektit ku janë theksuar të metat dhe trendët pozitive në këtë fushë. Këtu janë paraqitur ndryshimet që kanë ndodhur lidhur me transparencën komunale si dhe efektet që kanë pasur këto ndryshime tek autoritet komunale dhe publiku në përgjithësi. Dhe aspekti i tretë është niveli i qasjes në dokumentet zyrtare nëpër komunat e synuara. Këtu është vënë theks i veçantë tek autoritet komunale se si janë qasur kësaj fushe dhe çka ofrojnë për qytetarët në lidhje me qasjes në dokumentet zyrtare.

Megjithëse, është në fillim është vërejtur një progres i vogël në respektimin e dispozitave ligjore nga autoritet komunale lidhur me tri fushat e prekura në raport por këto janë përmisuar gradualisht deri në fund të raportimit. Për të përmbledhur, OJQ NOPM vërejtur gjatë periudhës raportuese e mbuluar

1. PARATHËNIE

Përmes këtij Raporti do të mundohemi të krijojmë informim të duhur qytetareve lidhur me aktivitetet që janë zhvilluara në periudhën gjashtë-mujore duke prekur tri fusha: pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje, transparencën dhe qasjen në dokumente zyrtare për tri Komunat (Kamenicës, Novo Berdes dhe Ranilugut). Raporti i hartuar përmbledh të dhëna për tri komuna dhe përfshin periudhën nga 1 Qershor deri më 31 dhjetor 2013.

Të dhënat e analizuara në këtë raport janë mbledhur përmes konsulentit dhe stafit të OJQ-ve që gjatë takimeve të ndryshme me zyrtarë komunale si dhe monitorimit të rregullt të tri komunave. Raporti shërben edhe si një mjet tjetër që do të rrisë transparencën, pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe qasjen në dokumente zyrtare në lidhje me aktivitetin e pushteteve lokale¹ për periudhën e raportimit.

Në raport, komunat janë elaboruar të grupuara në pjesë të ndryshme, kështu që për lexuesin është më e lehtë të njoftohet për komunën që i intereson. Për dallim nga kjo, në pjesën ekzekutive apo përmbledhëse të raportit, janë paraqitur të dhënat e përgjithshme të komunave të synuara, duke i përmbledhur çështjet e veçanta në një tërësi si dhe fushat e hulumtuara në veçanti duke ofruar informata shtese veç e veç për secilën fushë.

Po ashtu në kuadër të këtij raporti janë paraqitur edhe disa rekomandimet të përpiluar nga organizata që i konsideron si të nevojshme që komunat duhet të marrin në konsideratë në mënyrë që këto tri fusha të synuar të përmbledhen në punë sa i përket pjesëmarrjes së publikut në vendim marrje, rritjes së transparencës përmes pjesëmarrjes në qeverisje, buxhet dhe qasje në informata publike dhe dokumente.

¹ Kamenicës, Novo Berdes dhe Ranilugut

2. PJESEMARRJA E PUBLIKUT NE VENDIM-MARRJE

Pjesëmarrja e publikut ende mbetet sfide për komunën e Novo Berdes, Kamenicës dhe Ranilugut. Këtu përmenden disa faktorë që ndikojnë në pjesëmarrje të ulte të publikut në vendim-marrje. Autoritet komunale të tri komunave gjatë takimeve të ndryshme nënvizua se problemi kryesor i pjesëmarrjes së pamjaftueshme në vendim-marrje është largësia në mes qytetareve dhe objekteve të komunës kur kryesisht merren vendimet si dhe pamundësia e tyre për të marrë pjesë në vendim-marrje duke përmendur si faktor kryesor gjendjen ekonomike të qytetareve.

Kurse në anën tjetër, në takime me qytetare dhe përfaqësues të shoqërisë civile thuhet e kundërta e kësaj ku ata theksojnë se arsyet kryesore të pjesëmarrjes së ulte të qytetareve në vendim-marrje është mungesa e besimit se propozimet, sugjerimet dhe këshillat e tyre do të merren në konsideratë gjatë vendim-marrjes dhe si rrjedhojë do të merren vendime me përfshirje të publikut. Ndërkohe, ajo që është vërejtur tregon se qytetarët nuk duken edhe aq të inkurajuar për të qenë pjesëmarrës në takimet dhe seancat e kuvendit komunal. Madje, edhe takimet publike të organizuara lidhur me çështjet e interesit të përgjithshëm, siç mund të jenë miratimi i rregulloreve apo planeve të ndryshme komunale, nuk i ka nxitur qytetarët për të qenë pjesëmarrës. Pjesëmarrja e publikut ende mbetet e ulte por me një trend të përmisimit apo të rritjes nëpër mbledhje të kuvendeve komunale si dhe komiteteve për politike dhe financa dhe komunitete ku në ato mbledhje kryesisht të kuvendeve komunale² marrin pjesë prej një (1) deri tre (3) qytetare, kurse në mbledhje të komiteteve³ në gjashtë muajt e fundit numri kanë qenë i mirë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ku janë regjistruar një numër relativisht i vogël i qytetareve në këtë mbledhje. Komuna e Kamenicës gjatë gjashtë muajve Qershor- Dhjetor 2012 ka regjistruar pjesë 13 qytetare, Novo Berde 11, kurse në Ranilug vetëm 7 qytetare.

Mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriteri bazë i demokracisë që duhet të respektohet nga njësitë e qeverisjes vendore. Siç dihet të gjitha

² Komuna e Kamenicës gjatë gjashtë muajve Qershor- Dhjetor kanë marrë pjesë 25 qytetare, Novo Berde 19, kurse në Ranilug vetëm 14 qytetare.

³ Komuna e Kamenicës gjatë gjashtë muajve Qershor- Dhjetor kanë marrë pjesë 11 qytetare, Novo Berde 9, kurse në Ranilug vetëm 8 qytetare

komunat janë të obliguara për të drejtuar këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë , takime të drejtpërdrejta , informimin publik dhe çdo metodë tjetër me të cilin transparenca do të ndikojnë në avancimin e qeverisjes lokale. Organizimi i takimeve publike me qytetarë ndryshon nga njëra komunë në tjetrën e kjo vërehet edhe në këto tri komuna e synuara. Komuna e Ranilugut dhe Novo Berdes kanë kushtuar më shumë rëndësi në organizimin e takimeve publike me qytetarë , ndërsa komuna e Kamenicës ka qene me e rezervuar në këtë drejtim dhe nuk ka mbajtur asnjë takim publik me qytetare. Komuna e Kamenicës ka mbajtur një takim publik por në fakt është një takim që është organizuar dhe financuar nga organizata Zvicerane LOGOS HELVETAS dhe ky takim nga autoritetet komunale të Kamenicës konsiderohet se kanë organizuar një takim publik⁴.

Gjatë takimeve me zyrtaret komunal kjo ende konsiderohet si takimi i parë publik me qytetare që është edhe i detyrueshme sipas ligjit për vetëqeverisjen lokale. Përkundër kësaj pjesëmarrja e publikut në këtë takim mbi buxhetin që ishte moderuar nga konsulenti i LOGOS Helvetas ka qene mjaft e mire dhe mbi 200 pjesëmarrës në takim. Sidoqoftë, komuna e Kamenicës ka mbajtur gjashtë (6) takime tjera me qytetare mbi planifikimin e buxhetit me grupe të grave, këshillave lokale, rinjve dhe qytetarëve.

Vlen të theksohet se organizata LOGOS Helvetas në mënyrë të suksesshme ka lehtësuar takime publike mbi buxhetin në komunën e Novo Berdes dhe Ranilgut ku organizuar takime me publikun dhe vlen të theksohet se të gjitha këto takime janë shënuar me një pjesëmarrje masive dhe pazakonshme në këto komuna sepse zakonisht kur këto takime organizohen nga komunat, pjesëmarrja e publikut nuk është e theksuar. Kurse komuna e Novo Berdes ka organizuar pesë (5)⁵ takime me qytetarë mbi planifikimin e buxhetit me pjesëmarrje të grupeve të ndryshme të interesit Komuna e Ranilugut ka mbajtur një (1) takim me publikun dhe katër (4) takime me qytetare lidhur me planifikimin e buxhetit kurse në bashkëpunim me projektin e Zvicrës-Kosovës për vetëqeverisje lokale dhe decentralizim LOGOS me 18 Qershor 2013 ka organizuar debat Publike me temë „Planifikimi i buxhetit me pjesëmarrje të qytetarëve“ me pjesëmarrje prej mbi 120 qytetare.

⁴ 21 Qershor 2013

⁵ 11 dhe 17 Qershor, 15 Korrik, 21 Gusht dhe 25 Shtator

Megjithatë , tri komunat e synuar kane shënuar një rritje te takimeve⁶ te tyre mbi buxhetin gjate periudhës Qershor -Shtator ne krahasim me vitin e mëparshme kur janë organizuar dhjete (10) takime mbi planifikimin e buxhetit. Përfundimisht, kjo rritje e numrit të madh të takimeve është për shkak të organizimit të takimeve të tjera (përveç atyre të detyrueshme sipas nenit 68.1 të LVL) të cilat janë të organizuar në vende të vogla , lagjet , fshatrat dhe vendbanime të tjera me grupe te ndryshme te interesit.

Këto forma të organizimit kanë mundësuar që qytetarët të paraqesin vërejtjet e tyre , sugjerimet , dhe kërkesat në lidhje me nevojat e tyre. Prandaj, këto takime praktikisht paraqesin vlerat e demokracisë së drejtpërdrejtë , përkundër demokracisë indirekte , ku kërkesat e qytetarëve të realizojë me anë të të zgjedhurve te tyre apo të programeve të veçanta. Prandaj, ne vlerësojmë se aplikimi i kësaj forme të përgjithshëm të konsultimit duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe duhet të jetë një pjesë integrale e politikave komunale ne këto tri komuna.

Informimi i qytetarëve është hapi i parë i përfshirjes së tyre në vendimmarrje, qytetari i informuar nxitet që të bashkëpunoj me institucionet komunale, të marrë pjesë në dëgjimet publike dhe të jap ide dhe sugjerime për përmirësimin e kushteve të jetesës. Prandaj kërkohet nga zyrat e informimit, kryetaret, nen-kryetaret, kryesuesit dhe drejtorët e drejtorive qe te bashkërendojnë aktivitetet e tyre me zyrën e informimit dhe zyrën pritëse ne mënyrë qe te gjitha aktivitetet e komunës te prezantohen dhe publikohen për qytetare kurse zyrat pritëse te jene ne gjendje te ofrojnë dokumente dhe informata shtese për ndonjë aktivitet qe është kryer ne komunat përkatëse.

3. TRANSPARENCA KOMUNALE

Ne kuadër te transparencës komunale janë përcjellur kryesisht elementet më të rëndësishme të transparencës qe zakonisht përfshijnë: takime të hapura me qytetarë, paraqitje financiare për publikun, publikimi i njoftimeve dhe vendimeve te kryetarit për publikun e gjere, publikim i të hyrave të Kryetarit, nen-kryetareve, drejtorëve te drejtorive, kryesuesit të kuvendit dhe anëtarëve të kuvendit, punësim i personelit në mënyrë të ligjshme dhe të hapur duke respektuar ligjet ne fuqi etj. Për më tepër, si masa plotësuese

⁶ 15 takime mbi planifikimi e buxhetit

për transparencën llogariten edhe integriteti dhe etika publike, masat kundër korrupsionit dhe luftimi i konfliktit të interesit⁷. Sa u përket mbledhjeve të kuvendit, të gjitha mbledhjet e kuvendeve kanë qene të hapura për publikun. Informimi i qytetareve në vazhdimësi është bërë përmes ueb-faqes zyrtare të komunës, shpalljeve publike të vendosura në objektet e komunës, por edhe përmes radiove lokale

Megjithatë, komunat janë kujdesur të respektojnë rregullat për njoftimin e qytetareve me rastin e diskutimeve publike. Për më tepër, uebfaqet zyrtare të komunave në vazhdimësi kanë qene azhurnuara me informacione dhe aktivitetet e komunave. Madje, duke marrë parasysh sistemin e teleprezencës të instaluar në komuna, është krijuar mundësia e vendosjes së aplikacioneve në ueb-faqet zyrtare, ku qytetarët të kenë mundësinë për vëzhgimin e mbledhjeve të kuvendeve.

Në kuadër të takimeve të hapura me qytetare Komuna e Kamenicës ka pasur një progres sepse përveç takimeve të detyrueshme të kuvendit komunal si dhe mbledhjeve të komiteteve, zyrtarët komunal të kryesuar nga kryetari kanë organizuar pesëmbëdhjetë (15) takime me qytetare për çështje të ndryshme. Situata e njëjtë ka qene edhe me kryetare e dy komunave tjera të cilët kanë organizuar në Ranilug nëntë (9) takime jo-formale me qytetarë dhe në komunën e Novo Berdes dhjetë (10) takime jo-formale me qytetare për çështje të ndryshme. Sa i përket paraqitjes financiare, komuna e Kamenicës, Novo Berdes dhe Ranilugut ka qene mjaftë e suksesshëm sepse kanë përgatitur raporte periodike financiare të cilat janë prezantuar në komitetet për politike dhe financa dhe kuvendet komunale pas çdo tre-mujori.

Kurse vlen të theksohet se Kryetari Komunës së Kamenicës gjithmonë ka marrë pjesë në mbledhjet e komiteteve dhe kuvendit komunal kur janë diskutuar raportet financiar dhe ka qene i gatshëm të mbroj të dhënat e raportuar dhe mund të thuhet se me këtë ka treguar një respektim të ligjit mbi vetëqeverisjen lokale. Kurse prezenca e kryetareve të komunave të Novo Berdes dhe Ranilugut nuk ka qene mjaftë e theksuar kur janë diskutuar këto raporte financiare.

⁷ 21 Principles of good governance http://www.cipfa.org.uk/pt/download/governance_standard.pdf (Qasur në Shtator 2013)

Një prej indikatorëve më të rëndësishëm të transparencës, që është Web-faqja e komunës, kryesisht duket se i është dedikuar vetëm kryetareve të komunave, pasi ajo freskohet kryesisht vetëm me të dhëna mbi aktivitetet e tyre dhe njoftimeve për fillimin e investimeve dhe projekteve kapitale. Kurse sa i përket aktiviteteve të tjera komunale që zhvillohen nga drejtorit tjera si dhe legjislativi ka shumë pak informata mbi to ose pothuajse fare nuk mbulohen aktivitetet e tyre.

Në web-faqe nuk publikohen procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit dhe të komiteteve të tij, aty mund të gjejmë disa procesverbale nga viti 2011 e tutje. Lidhur me këtë, komuna e Kamenicës qëndron mjaftë mirë sepse publikon dhe freskon procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të kuvendit komunal dhe komiteteve të viteve 2011, 2012 dhe 2013, kurse në Ranilug nuk mund të gjejmë procesverbalet mbi takimet e mbajtura të kuvendit komunal. Kurse në komunën e Novo Bërdes mund të gjejmë disa procesverbalet vetëm nga viti 2013 dhe 2012 për mbledhjet e mbajtura të kuvendit komunal. Për më tepër komuna e Novo Bërdes është e vetmja komune që publikon transmetimin e mbledhjeve të kuvendit ku qytetarët janë në gjendje të përcjellin rrjedhën e mbledhjeve dhe diskutimeve të anëtareve të kuvendit komunal kurse komuna e Kamenicës dhe Ranilugu nuk i publikojnë fare.

Sa i përket publikimit të rregullt të konkurseve, raporteve, rregulloreve, njoftimeve dhe dokumenteve të tjera, ato bëhen në mënyrë të rregullt dhe në dy gjuhë nga tri komunat. Mirëpo sa i përket publikimit të vendimeve të kuvendit komunal, në komunën e Kamenicës mund të gjenden vetëm disa vendime dhe jo të gjitha nga viti 2012 kurse për vitin 2013 nuk ka asnjë vendim të publikuar për publikun. Komuna e Ranilugut dhe Novo Bërdes qëndrojnë mjaftë mirë dhe të gjitha vendimet e kuvendit komunal të 2013 e më herët mund të gjenden në webfaqet komunale.

Rregullimet e akteve nënligjore duhet të bëhet nga organi lëshues përkatësisht komunat, ndërsa në faqet e internetit të komunave është vërejtur se aktet nënligjore⁸ të miratuara në të shumtën e rasteve kanë qenë të publikuara në aplikacione të ndryshme dhe janë të vështirë për të identifikuar nga publiku i gjere. Gjithashtu, aktet nënligjore publikuara nuk janë bërë sipas llojit të tyre, por është bërë në një dosje të përbashkët, ku përfshihen aktet nënligjore të ndryshme dhe pa ndonjë përzgjedhje.

⁸ Rregullore dhe vendime për ushtrimin e kompetencave të komunës në fushat e përcaktuara me kornizën ligjore

Për shkak të transparencës është gjithashtu e rëndësishme që të ketë qasje në aktet nënligjore dhe vendimet të miratuara nga kryetari i komunës. Asnjëra komuna nuk e ka të rregulluar kërkesën për aktet nënligjore të miratuara nga kryetari i komunës në faqet komunale. Vlen të theksohet, asnjëra komuna nuk kanë publikuar ende ndonjë akt nënligjore dhe vendime të miratuara nga kryetari i komunës. Siç kemi vënë re, gjatë periudhës Janar - Qershor 2013 nuk ka pasur vendosje të informacionit lidhur me vendimet e marra nga kryetareve të komunave, dhe kjo mbete një sfide e vërtetë.

Freskimi i rregullte dhe mos përditësimi i web-faqes me dokumentet e fundit të komunës e tregon edhe seriozitetin dhe angazhimin e komunave që të aplikojnë një qeverisje transparente. Kryetaret e Kamenicës, Novo Berdes dhe Raniliugut i kanë respektuar edhe disa elemente të tjera të rëndësishme të transparencës, siç janë: publikimi i të hyrave të kryetarit (raporte financiare tre-mujore) dhe raportet e jashtme të auditimit, kurse në komunën e Kamenicës janë diskutuar në Komitetin për Politike dhe Financa dhe kuvendin komunal edhe raportet e brendshme të njëjesisë komunal të auditimit e cila nuk është praktike në komunat tjera. Kurse sa i përket publikimi të raporteve të auditimit të jashtme, të tri komunave qëndrojnë mirë sepse i kanë të publikuar në webfaqet e tyre por komunat vazhdojnë të mos i publikojnë për publikun përgjigjet sa i përket rekomandimeve të adresuar për permisimin e çështjeve të caktuara në kuadër të auditimit të jashtëm që duhet të behet një muaj pas dorëzimit të raportit të auditimit të jashtëm.

Dhe krejt për fund, vlen të përmendet se zyrtarët e administratës komunale të tri komunave kanë treguar integritet dhe në përgjithësi kanë aplikuar një qasje bashkëpunuese me OJQ NOPM dhe konsulentin. Komunikimi me zyrtarët komunal dhe shoqërinë civile gjatë takimeve të ndryshme si dhe punëtorive është ngritur në një nivel më të lartë krahasuar me qeverisjen e mëparshme kur shoqëria civile ka monitoruar punën e komunave.

Kjo me siguri është mundësuar edhe nga marrëveshjet e memorandumit të nënshkruara me kryetaret e komunave përkatëse, pasi që këto marrëveshje janë publikuar në webfaqet komunale për informim të zyrtareve komunal dhe qytetareve dhe si rezultat bashkëpunim ka qene në nivel shumë të larte.

4. QASJA NE DOKUMENTE ZYRTARE

Në Kosovë, qasja në dokumentet zyrtare është e garantuar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike⁹, dhe Ligjin mbi Procedurat Administrative¹⁰ që përcaktojnë kushtet në bazë të të cilave mund të jepet qasja në dokumentet zyrtare.

Çfarë është një dokument zyrtar?

Një dokument zyrtar është çdo dokument i ruajtur, i hartuar apo i pranuar nga institucionet publike. Këto dokumente mund të regjistrohen në çdo formë, si p.sh.: dokumente të shkruara, harta, skica, fotografi, audio regjistrime dhe video inçizime, të dhënave të arkivuara në formatin elektronik, kopje të printuara, apo ndonjë format tjetër.¹¹

Gjendja ne Kamenice, Ranilug dhe Novo Berde ne raport me qasjne ne dokumente zyrtare

Qasja ne dokumente zyrtare mbetet ende ne nivel jo te kënaqshëm ne tri komunat. Ne tri komunat e Kamenicës, Novo Berdes dhe Ranilugut vërehet se mungon informimi i sakte i autoriteteve komunale për përgjegjësit e tyre ndaj qasjes ne dokumente zyrtare kurse situatë është edhe me pavolitshme për qytetaret te cilët nuk dine fare se kush është personi kontaktues për qasje ne dokumente zyrtare.

Lidhur me këtë qytetaret kryesisht i drejtohen zyrtareve te ndryshëm komunal pa pasur një adrese te sakte se kush merret me kërkesat e tyre. Plus as komunat nuk ofrojnë ndonjë shpjegim apo informate shtese se ku duhet te drejtohen nëse kane nevojë për qasjen ne dokumente zyrtare. Kurse e tera behet edhe me vështirë kur qytetaret shkojnë për te kërkuar një dokument zyrtare për ndonjë çështje te caktuar e atyre ju thuhet se nuk kane drejte te kenë qasje ne atë dokumente zyrtare pa ju ofruar ndonjë sqarim te përshtatshme dhe te bazuar ne ligjet te aplikueshme se pse ai dokument nuk është i qasshëm.

As webfaqet komunal nuk ofrojnë as informata lidhur me qasjen ne dokumente zyrtare e aq me pak informata për legjislacionin ne fuqi qe e rregullon këtë çështje mjaftë te

⁹ Ligji Nr.03/L – 215 mbi Qasjen në Dokumentet Publike, 7 tetor 2010, në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze në <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/RQ.aspx>

¹⁰ Ligji Nr.02/L-28 mbi Procedurën Administrative, 13 maj 2006 në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze në <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/RQ.aspx>

¹¹ Neni 3 i Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Publike. Këtu përfshihen pasqyrat financiare, raportet, strategjitë, dokumente të politikave dhe shumë tjera

rëndësishme për publikun. Kjo situatë ka bërë që numri i kërkesave të adresuar tek institucionet komunale kanë qenë simbolik (16 raste në tri komuna) gjatë periudhës Janar - Qershor 2013 por më i lartë se vitin e kaluar të së njëjtës periudhe ku ishin regjistruar vetëm 9 në tri komuna. Kjo ka qenë një arritje sepse përkundër faktit se zyrtarët komunal kontaktues për qasje në dokumente zyrtare nuk kanë qenë as të emëruar apo të caktuar të merren me çështje të kërkesave për qasjen në dokumente zyrtare. Gjatë kësaj periudhe në Komunën e Kamenicës janë regjistruar 14 raste apo kërkesa, Ranilug nuk ka pasur asnjë kërkesë kurse në Novo Berde kanë qenë vetëm dy (2) raste për qasje në dokumente zyrtare të cilat kanë qenë kryesisht të adresuara nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, qytetarëve dhe partive politike¹². Kërkesat e adresuar për qasje në dokumente zyrtare kanë qenë kryesisht për harxhimet buxhetore, raportet financiare periodike të kryetarit, raporte financiare, vendime të kuvendit të komunës, projektet infrastrukturore, prokurim, investime kapitale dhe raporte të auditimit.

Emërimet për detyra shtese të zyrtarëve komunal për qasje në dokumente zyrtare janë bërë pas muajit Qershor 2013, ku në komunën e Ranilugut është bërë emërimi në muajin Tetor 2013, në komunën e Novo Berdes në fund të muajit Korrik dhe në komunën e Kamenicës është bërë emërimi në muajin Qershor. Zyrtarët e caktuar në komunat përkatëse vijnë nga zyrat e informimit në Komunën e Kamenicës dhe Novo Brdes dhe nga zyra pritëse në Komunën e Ranilugut.

Lidhur me këtë, nga ana e komunave nuk janë zhvilluar asnjë fushatë informuese me qëllim të informimit të opinionit publik mbi obligimet e komunave në raport me qytetarët, si në aspektin e përfshirjes së qytetarit në vendim-marrje dhe informimin e tyre, si dhe lidhur me procedurat e zbatimit të ligjit mbi qasjen në dokumente zyrtare. Por për informimin e opinionit publik lidhur me qasjen në dokumente zyrtare është perkuajdesur, OJQ NOPM e cila së bashku me autoritete përkatëse relevante të komunave fillimisht ka hartuar përmbajtjen e fletpalosjeve me informata se si, ku dhe çfarë hapa të ndermirren nga qytetarët në mënyrë që të qasen lirshëm dokumenteve publike në institucionet komunale. Një numër prej 1,200 fletpalosjeve janë shpërndarë tek autoritete komunale dhe qytetarëve të tri komunave në tri gjuhë.

¹² Vetevendosja dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

5. TE GJETURAT E RAPORTIT DHE REKOMANDIMET

1. Kryetari, nen-kryetaret, drejtoret e drejtorive dhe kryesuesit e kuvendeve komunale të hartojnë plane te punës vjetore.
2. Planet vjetorë te ekzekutiveve dhe legjislativeve te publikohen ose te jene te qasshme për publikun dhe shoqërinë civile
3. Te ri-hartohen dhe ri-shikohen planet e veprimit për transparence dhe zbatohet rregullorja komunale me transparencën
4. Rregullorja mbi transparencën te ndryshohet sipas nevojës dhe te behet publike për qytetarë dhe shoqërinë civile
5. Plani i veprimit për transparence dhe rregullorja komunale te behën udhërrëfyes për punën e komunave ne rritjen e transparencës
6. Zbatimi i praktikave më të mira për shpërndarjen e informatave lidhur me takimet e kuvendeve komunale, duke përdorur format më efikase për të informuar qytetarët.
7. Të funksionalizohen web-faqet e komunës duke përditësuar ato ne mënyrë te rregullte dhe duke zbatuar dy-gjuhësinë
8. Të hartohet një rregullore komunale për ndarjen e bursave për student
9. Të informohen rregullisht qytetarët për aktivitetet e komunës si te ekzekutivit dhe legjislativit përmes publikimi te njoftimeve ne webfaqe, media dhe panot informuese te komunës
10. Të gjitha aktet e miratuara në kuvendet komunal dhe aktet nga kryetari i komunës të publikohen në faqen zyrtare të komunës ne mënyrë te rregullte
11. Kryetari të emëroj një zëdhënës të ekzekutivit në mënyrë që të ngritet ne niveli i komunikimit të mediave, shoqërisë civile me zyrën e kryetarit dhe në të njëjtën kohë të fuqizohet zyra për komunikim me media dhe publikun
12. Kryetaret t'i respektojnë ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke filluar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Statutin e komunës, si dhe Udhëzimet Administrative të nxjerra nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

6. PERFUNDIMET

- ❖ Ne përgjithësi komunat kane respektuar Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligje te tjera sekondare, por duke dështuar ne mbajtjen e takimit te dyte publik te paraparë me ligjin për vetëqeverisje lokale;
- ❖ Ende mbetet pune për tu bere nga komunat e synuar lidhur me azhurnimin e informatave ne uebfaqet zyrtare përkundër permisimi te situatës ne gjashte muajt e fundit (Qershor- Dhjetor 2013);
- ❖ Afatet dhe njoftimet për mbledhje te kuvendeve dhe komiteteve si dhe takimeve tjera publike me qytetare, si dhe dërgimi me kohe i materialit te për këto takime , kryesisht janë respektuar
- ❖ Janë evidentuar një numër i shkeljeve ligjore me rastin e nxjerrjes se akteve komunale ne Kuvendet e Komunave për shkak te mungesë se koordinimi te aktiviteteve dhe këshillimit ne aspektin ligjor me zyrtaret e zyrave ligjore dhe kryetareve.
- ❖ Kërkesat dhe rekomandimet e autoriteteve mbikëqyrëse (Ministrisë se Administrimit te Pushteti Lokale) për shqyrtimin e akteve te kuvendit komunal dhe ekzekutive lidhur me shqyrtimin e rregullt dhe te detyrueshme te ligjshmërisë pjesërisht merren ne konsiderate dhe zbatohen me vonesa nga komunat.
- ❖ Plane te veprimit për transparencën te vjetruar dhe jo te përshtatshme me kohen dhe periudhën digjitale
- ❖ Komunat kane emëruar zyrtar komunal/persona kontaktues për qasje ne dokumente publike dhe zyrtare si dhe kane ofruar kontaktet e tyre për tu ofruar qytetareve qasje sa me te lehtë dhe te shpejte.
- ❖ Problemi më i madh mbetet mungesa e qartësisë për klasifikimin e dokumenteve të cilat duhet të jenë të hapura për publikun e cila jo.